



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 270/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë , duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Klinë, paraqitur kundër Iniciativës Qytetare për Klinë (IQK), për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugët publike për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Klinë kështu që Iniciativës Qytetare për Klinë (IQK) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 250(dyqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 17. 10. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 17 tetor 2013 në rrugën Abedin Rexha në Klinë rreth orës 13:00 anëtarë të IQK-së në Klinë kanë vendosur banerë të kandidatit të tyre mbi rrugë publike. Me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës IQK ka bërë shkelje të nenit 33 pika b) të LZP-së e cila ndalon vendosjen e materialit zgjedhor mbi rrugët publike.. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografimin si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi IQK, me datën 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.20, ora 12:00. PZAP-i përkundër kërkesës së bërë nuk pranoi përgjigjen në ankesë nga IQK-ja, andaj në mbështetje të nenit 5.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it vazhdoi me shqyrtimin e më tutjeshëm të ankesës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se baneri i kandidatit të IQK-së është i vendosur mbi rrugët publike të trafikut e i cili veprim është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se Iniciativa Qytetare e Klinës (IQK) ka vendosur banerin e kandidatit të tyre në vendin e palejuar për vendosjen e tyre. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se IQK, merr pjesë përherë të parë në zgjedhjet lokale dhe atë vetëm në komunën e Klinës.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstaton se nga ana e IQK-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që baneri i kandidatit për asamble të komunale nga IQK-së është i vendosur mbi rrugët publike të trafikut, si dhe duke pasur parasysh se kjo iniciativë merë pjesë përherë të parë në këto zgjedhje veprime këto që kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 270/2013 më datën 25.10.2013.

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*